



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Tiranë, më 05.08.2021

NJOFTIM

ULET VIJA E FINANCIMIT PËR MASAT MBËSHTETËSE DIREKTE TË VITIT 2021

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural njofton uljen e vijës së financimit për aplikimet sipas masave mbështetëse të fermerëve dhe sipas listave të shpallura, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Udhëzimin Nr. 3 datë 26.02.2021, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural” i MBZHR dhe MFE, si dhe Urdhrit të Ministrit nr. 331, datë 04.08.2021 , “Për rialokimin e fondit të Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2021”

Njoftimi mbi uljen e vijës së financimit për “**Listat e Aplikimeve të Kualifikuara**”, të cilat gjenden në faqen zyrtare: www.azhbr.gov.al, për masa mbështetëse direkte, financuar nga Programi Kombëtar, viti 2021 sipa

Agropikat janë në gatishmëri për dhënie informacioni të aplikantëve të cilët janë brenda vijës së financimit.

Më poshtë po ju njoftojmë numrin rendor të aplikantëve si dhe numrin e kodit të aplikimit që përfshihet mbi vijën e financimit.

- **Masa 1:** Tufa bazë e matrikulluar – Vija e financimit ishte ne numrin rendor 1886 për kodin e aplikimit me numër 3408 - Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 1890, për kodin e aplikimit me numër 3416.
- **Masa 2:** Parqet me koshere bletësh - Vija e financimit ishte ne numrin rendor 677 për kodin e aplikimit me numër 4264– Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 763, për kodin e aplikimit me numër 4940.
- **Masa 3:** Zëvendësim plasmasi në sesa ekzistuese – Vija e financimit ishte ne numrin rendor 463, për kodin e aplikimit me numër 11306- Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 466, për kodin e aplikimit me numër 11320.
- **Masa 4:** Mbjellje Bimë Aromatike dhe medicinale – Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 104, për kodin e aplikimit me numër 1774.

Fermerët të cilët iu përshihet aplikimi me fond të buxhetit të shtetit në datë **05.08.2021**, kanë afatin e dorëzimit të dokumenteve shtesë deri në datë **20.08.2021**. Dorëzimi përtej këtij afati do të rezultojë me skualifikim të aplikimit.